



# ORDO FRATRUM MINORUM MINISTER GENERALIS



## TË GJESËMË SHPRESËN NË MES TË PANDEMISË COVID-19

### Letër drejtuar Vëllezërve të Urdhrit

Vëllezërit e mi të dashur të Urdhrit,

me fjalët e atit tonë serafik, *Zoti ju dhashtë paqe!*

Prej kohësh e kam në mend t'ju shkruaj edhe një herë gjatë këtij momenti veçanërisht angazhues në jetën tuaj të botës, për t'ju përditësuar në lidhje me disa të mira e sfida që jemi duke përballuar si bashkësi botërore dhe për të nxitur të gjithë ne që të ndjekim drejtimin e të ruajmë fenë. Kam zgjedhur këtë datë, që përkujton miratimin nga ana e papës Honori III në vitin 1223 të Rregullës dhe Jetës përfundimtare (Rregulla e Vulosur), për t'ju folur për çështje urgjente që peshojnë mbi të gjitha zemrat tona.

Gjatë këtyre muajve të fundit kam qenë në kontakt me disa provincialë dhe kustodë për t'u informuar në lidhje me shëndetin tuaj, vëllezërit e mi të dashur, dhe për të komunikuar fjalë ngushëllimi, solidariteti e shprese të krishterë. Viti 2020 do të kujtohet përgjithmonë si ai në të cilin e gjithë bashkësia njerëzore u rrëzua në gjunj, u poshtërua prej agjentit patogjen Sars-CoVid-2 (më tej, CoVid-19). Ndërsa pandemia vazhdon të shkatërrojë bashkësitë njerëzore, duke i lënë ato në vuajtjen e patregueshme që shkakton, janë duke dalë edhe pasoja të tjera të rënda shoqërore. Familje, miq e vëllezër të Urdhrit e kanë ndier ndikimin psikologjik dhe emotiv që vjen prej ruajtjes së distancave shoqërore, vendosjes së maskave mbrojtëse dhe mosshprehjes së formave fizike të dashurisë, duke na privuar nga diçka kaq jetësore dhe e nevojshme për jetën njerëzore e bashkësiore. Edhe humbja e vendeve të punës dhe mjeteve të jetesës është duke pasur një ndikim shumë negativ në jetën e miliarda personave në çdo krahinë të botës. Personat janë gjithnjë e më të shtyrë drejt një varfërie kronike. Ka një ndjenjë në rritje frike, pasigurie, pafuqie dhe dëshpërimi.

Kjo pandemi globale dhe pasojat e saj anësore janë duke pasur edhe një ndikim të rëndë në jetën e të gjithë fretërve të Urdhrit. Disa vëllezër të Urdhrit kanë vdekur. Të tjerë janë sëmurë rëndë dhe kanë kaluar kohë në spital. Të tjerë e kanë kaluar kohën e tyre në karantinë, të izoluar prej vëllezërve të vëllazërisë. Edhe puna jonë, angazhimet tona shërbestare në famullitë, në shkollat, në programet e shërbimit social, në tërheqjet, në punën për drejtësinë, paqen e kujdesin për shtëpinë tonë të përbashkët janë ndërprerë të gjitha seriozisht prej pandemisë. Disa vëllezër kanë bashkëndarë me mua problemet e tyre të depresionit, ndjenjat e vetmisë, ndjesinë e tyre të humbjes së autonomisë dhe pushtetit mbi jetën e tyre dhe madje edhe ndjenjat e tyre të zemërimit e të trishtimit që kanë zënë vend në zemrat e tyre. Mund t'i kuptoj këto ndjenja sepse edhe unë i kam ndier në një mënyrë apo në një tjetër.

Tani më shumë se kurrë, kemi nevojë të sajojmë mënyra të reja për të qëndruar së bashku, duke i shumuar momentet në të cilat të bashkëndajmë vështirësitë dhe zemërimet që jemi duke jetuar, edhe pse respektojmë normat e shëndetit publik për të mirën e përbashkët. Na e kujton këtë shën Françesku në Rregullën dhe Jetën: “Dhe kudo janë e do të takohen fretërit, le të dëftohen familjarë me njëri-tjetrin. Dhe secili t’ia dëftojë me besim tjetrit nevojat e veta, sepse, nëse nëna e ushqen dhe e do birin e vet për nga mishin, sa më me shumë kujdes një njeri duhet ta dojë dhe ta ushqejë vëllain e vet shpirtëror!” (RrV, kap. 6).

Kriza aktuale shëndetësore e ka tjetërsuar seriozisht mënyrën me të cilën në Kurien Gjenerale e zhvillojmë shërbimin tonë ndaj bashkësisë universale. Nuk kam mundur t’ju vizitoj, vëllezërit e mi të dashur, as definitorët nuk kanë mundur ta shoqërojnë jetën e entiteteve tuaja në mënyrë që të shprehin afërsi dhe “personalizëm françeskan”. Ky personalizëm i jep një vlerë të madhe takimit “fytyrë për fytyrë”, bashkëndarjes së lutjes, vakteve dhe jetës së përbashkët. Kemi qenë të detyruar t’i zhvillojmë takimet tona nëpërmjet Zoom-it, Skype-it apo formateve të tjera elektronike. Pavarësisht prej këtyre kufizimeve, është bërë çdo përpjekje për t’i mbajtur të hapura kanalet e komunikimit me shpresën që të mund t’i japim zemër njëri-tjetrit për t’i mbajtur sytë të ngulur në Zotin Jezus, për t’u kujdesur për njëri-tjetrin dhe për t’u shprehur solidaritetin tonë atyre që na rrethojnë dhe që janë duke vuajtur.

Një sfidë tjetër që po përballojmë në bashkësi ka të bëjë me situatën tonë financiare. Ministrat më kanë komunikuar se një pasojë shumë shqetësuese e CoVid-19 ka qenë pakësimi i madh i hyrjeve edhe pse shpenzimet vazhdojnë të rriten. Rezultati është ai i një efekti domino: vëllazëritë lokale dikur autonome tani u duhet të kërkojnë asistencë financiare; provinca dhe kustodie kanë vështirësi t’i mbajnë fretërit e, edhe më e vështirë është t’i përçojnë Kuries Gjenerale kontributet e tyre të solidaritetit. Kuria varet prej këtyre kontributeve për të ndihmuar në mbështetjen e shtëpive vartëse të Urdhrit dhe kërkesat e formimit e misionit të shumë entiteteve ekonomikisht më të varfra. Gjithashtu, varemi edhe prej fitimeve të Fondacionit Opera Antonianum që merret me mbikëqyrjen e veprimtarisë së hotelit Il Cantico dhe të Auditorium-it të Universitetit Papnor Antonianum. Pandemia ka shkaktuar një humbje të hyrjeve. Fondacioni nuk do të mund t’i japë asnjë kontribut bilancit përfundimtar të Kuries të viteve 2019, 2020 dhe ndoshta edhe 2021. Tashmë jemi duke e ndier këtë goditje.

Vëllezër, shpresoj që në këto momente të vështira të jeni duke gjetur më shumë kohë për t’u përqendruar në atë që ka vërtet rëndësi për jetët tuaja. Sikurse na kujtojnë Kushtetutat Gjenerale, “e kemi për detyrë të bëjmë një jetë rrënjësisht ungjillore... në një shpirt lutjeje dhe devocioni, e në bashkim vëllazëror... një dëshmi pendese dhe minoriteti... në dashurinë ndaj të gjithëve... duke predikuar pajtimin, paqen e drejtësinë... dhe të dëftojmë respekt për botën e krijuar” (neni 1§2). Ky të jetuar i jetës ungjillore na jep një bazë shpirtërore në momentet e provës dhe vuajtjes. Vëllazëria duhet të jetë një oaz shprese, një vend në të cilin të merret forcë prej mirësjelljes dhe prej kujdesit që dëftojmë për njëri-tjetrin. Është e rëndësishme edhe që t’i kushtohemi kujdesit për vetveten, përfshirë ushtrimin, leximin, lutjen e studimin, duke forcuar trupin tonë, mendjet tona dhe zemrat tona për ta ruajtur drejtimin. Angazhimi ynë për të qenë vëllezër të të gjithë personave duhet të na bëjë që të përfshihemi në një reflektim më të thellë në lidhje me frakturat e shumta –

ekonomike, politike, shoqërore, format e ndryshme në rritje të pabarazive, racizmit dhe ‘izmave’ të tjerë – ‘viruseve’ të tjera – që e minojnë të mirën e përbashkët dhe angazhimin për solidaritetin global.

Kërkojmë një përhapje të njohurisë dhe intuitës që t’u prijnë shkencëtarëve, mjekëve dhe vepruesve shëndetësorë në kërkimin e tyre të vaksinave, terapive për të pakësuar pasojat e infeksionit nga CoVid-19 dhe për kujdesin e përgjithshëm ndaj personave më të goditur. I bëjmë thirrje urtisë së Salomonit për krerët tanë politikë, që të mund të kërkojnë të mirën e përbashkët, të njohin zemërimet e tyre dhe të personave për të cilët janë të thirrur të kujdesen e t’u shërbejnë, dhe të gjejnë mënyra të reja për të shoqëruar ata që kanë më shumë nevojë për asistencë të veçantë. T’i shtrijmë duart tona dhe krahët tanë për të përqaftuar, në kuptimin figurativ, vëllezërit e motrat tona, duke bashkëndarë kohën tonë dhe burimet tona të çmueshme me më nevojtarët si shenjë e qartë se jemi të gjithë të bashkuar nga lidhje, jemi të gjithë anëtarë të së vetmes familje të Hyjit, vëllezër e motra që ecim së bashku në rrugën që është duke na çuar drejt realizimit të plotë të mbretërisë së Hyjit në të tashmen dhe në amshim. Me fjalët e papa Françeskut, tragjedia e pandemisë CoVid-19 ndihmoftë për t’i bërë copë “ato siguri të rreme e të kota me të cilat i kemi mbushur agjendat tona, projektet tona, zakonet dhe përparësitë tona... [që të mund të arrijmë] atë (të lume) përkatësi të përbashkët së cilës nuk mund t’i shmangemi: përkatësisë si vëllezër” (VGj 32).

Ndërsa përkujtojmë të gjithë shenjtërit e Urdhrit, të lutemi që, me ndihmën e Hyjit, ndërmjetësinë e shën Françeskut, të të gjithë shenjtërve tanë françeskanë dhe Marisë, Mbretëreshës së Urdhrit françeskan, të mund ta rindezim zellin tonë fillestar dhe të angazhohemi përsëri për të jetuar Rregullën dhe Jetën të propozuar nga shën Françesku dhe të miratuar nga papa Honori III. Të marrim forcë prej dëshmisë besnike të shenjtërve tanë françeskanë të cilët, edhe ata, kanë jetuar shumë sfida, por kanë ditur ta mbajnë të gjallë dashurinë dhe shpresën që kanë marrë prej fillimit të ecjes së tyre ungjillore. Të përtërijmë angazhimin tonë për të qenë njerëz të shpresës, vëllezër të dashur për njëri-tjetrin, kërkues të drejtësisë, paqes së njëmendtë, nxitës të mirësjelljes, vëllazërisë dhe solidaritetit ndaj të gjithë personave dhe ndaj krejt gjithësisë së krijuar. Të presim me parapërgatitje aktive Kapitullin Gjeneral të vitit 2021, kur të bashkohemi përsëri për të reflektuar dhe për të përqaftuar temën e Kapitullit: Të përtërijmë Vizionin tonë. Të përqafojmë të Ardhmen tonë – “Zgjohu ti që fle... dhe do të të shndrisë Krishti” (Ef 5,14). Hyji është këtu! Shpresa është afër!

Në përfundim, ju ftoj të luteni me fjalët që vijojnë të marrura prej “Lavdeve të Hyjit” të shkruara nga shën Françesku dhe të besuara fra Leonit në La Verna në vitin 1224:

*Ti je bukuri, Ti je butësi,  
Ti je mbrojtësi, Ti je rojtari dhe mbrojtësi ynë,  
Ti je këshqjellë, Ti je strehim. Ti je shpresa jonë!  
Ti je feja jonë, Ti je dashuria jonë,  
Ti je e gjithë ëmbëlsia jonë, Ti je jeta jonë e pasosur:  
o Zot i madh dhe i admirueshëm, Hyj i gjithëpushtetshëm, Shpëtimtar i mëshirshëm. AMEN.*

Romë, 29 nëntor 2020

Festa e të gjithë shenjtërve të Urdhrit Serafik

Vëllazërisht i juaji



Fr. Michael A. Perry, OFM  
Ministër Gjeneral dhe Shërbëtor

Prot. MG 168/2020